



BASHKIA E TIRANËS

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë subjektet e interesuar se në zbatim të vendimit nr. 9 dt 17.02.2016 të KKT-së për "Zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit" (i ndryshuar), në mbështetje të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ju informojmë se:

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka nisur hartimin për fazën e parë të njësive strukturore : **5/24(ndryshim) dhe fazat e dyta të Planeve të Detajuara Vendore të njësive strukturore 11/6 A4(ndryshim), 11/1 ASHP4, 4/1 ASH2&ASH3, 2/23 zona A3, 2/13 zona A1, 9/7 A1&A2, 10/8 B1 dhe 7/39 A7&B8.**

Këto PDV, pasi u shqyrtuan nga sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit (Drejtoria e Planifikimit të Territorit/ DPPZHT), rezultuan në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës të miratuar me vendimin nr.1 të KKT-së dt 15.02.2013 dhe legjislacionin përkatës, ndaj do të nisë procedura për shqyrtimin administrativ të tyre.